



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NPT HAXHIJAJA shpk" të datës 15.07.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "164 Furnizimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor" me nr. të prokurimit 616-26-4982-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NPT HAXHIJAJA shpk" të datës 15.07.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "164 Furnizimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor" me nr. të prokurimit 616-26-4982-1-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NPT HAXHIJAJA shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 15.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "164 Furnizimi i fermerëve me mekanizëm bujqësor" me nr. të prokurimit 616-26-4982-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Në kërkesën nr. 1 është përcaktuar, citojmë: "OE duhet të ketë një agronom të diplomuar për dhënien e këshillave për fermerë për përdorimin e pajisjeve bujqësore." Ndërsa si dëshmi është kërkuar: "Të dorëzohet diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe kontrata e punës minimumi 1 (një) vit, sa zgjat periudha e monitorimit." Vlerësojmë se kjo kërkesë nuk lidhet me objektin e prokurimit, pasi kjo procedurë është zhvilluar për furnizim me pajisje/mekanizëm bujqësor dhe jo për ofrim shërbimesh këshilluese. - Në Dosjen e Tenderit, konkretisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit, te kërkesat menumër 9.1 dhe 9.2, që kanë të bëjnë me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, në kërkesën nr. 2 është përcaktuar, citojmë: "OE duhet që gjatë procesit të aplikimit ta dorëzojë katalogun me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar t'i kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalogun e dorëzuar gjatë aplikimit, pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do t'i ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit." Ndërsa si dëshmi është kërkuar: "Kopja e katalogut me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar t'i kenë specifikat e kërkuara. Të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalog." Konsiderojmë se kjo kërkesë është e paqartë dhe lë hapësirë për interpretim subjektiv, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar asnjë kriter objektiv mbi bazën e të cilit do të vlerësohet nëse "cilësia e pajisjeve është e lartë" apo nëse prodhuesi është "kompani e pranueshme për cilësi të prodhimit".

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kërkesat për stafin profesional janë të domosdoshme për arsye se ekziston një periudhë e monitorimit të pajisjeve dhe përdorimit të tyre gjatë të cilës sipas këtij projekti fermerët duhet të kenë një adresë ku të kërkojnë këshilla për përdorimin e pajisjeve bujqësore me të cilat furnizohen. Pra ekziston edhe një shërbim i këshillimit të domosdoshëm dhe pikërisht për të mbuluar këtë aspekt është vendosur kjo kërkesë në DT. Prandaj pretendimi i parë është i pabazuar. Sa i përket pretendimit të dytë me të cilin kundërshtohet kërkesa për katalogun, është gjetur se edhe kjo kërkesë është e pabazuar sepse dorëzimi i katalogut nga OE është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin e produkteve të ofertuara në raport me cilësinë dhe standardin e kërkuar sipas specifikave të DT.

Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.07.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.